



Nr. 994. Prot
datë 09/06/2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJESJELLES KANALIZIME SH A POGRADEC
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Vendim Nr. 3. /09/06/2023

Sot, më datë 09 Qershor 2023, Ujesjelles kanalizime Pogradec sha, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J64103615J, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga likuidatori i shoqërisë zoti Ferdinand Kullolli, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

- Përfundimi i procedurave të likuidimit dhe çregjistrimi i shoqërisë.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria është shpallur në likuidim në datën 31 Mars 2023. Vendimi si dhe njoftimet e kreditorëve janë publikuar rregullisht në QKB. Shoqëria nuk ka pasur aktive dhe detyrime, pasi në tërësi aktiviteti ekonomik dhe aktivitetet bashku me detyrimet janë transferuar në favour të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec Sha në datë 31.12.2022.

Pasi u shqyrtua bilanci përfundimtar i mbylljes së procedurave të likuidimit i datës 08 Qershor 2023 si dhe raporti i likuidatorit, konkludohet se shoqëria nuk disponon me asete dhe nuk ka detyrime ndaj të tremeve apo ndaj autoriteteve publike. Gjithashtu, shoqëria nuk zhvillon më aktivitet ekonomik dhe në këtë mënyrë mund të deklarohet mbyllja e procedurave të likuidimit dhe shoqëria mund të çregjistrohet.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja e Përgjithëshme vendosi:

- (1) Miratimin e pasqyrave financiare për periudhën 1 Janar 2023 deri 08 Qershor 2023 si dhe rezultatin financiar humbje prej 1,916,097 leke për këtë periudhë;
- (2) Humbjet e mbartura prej 185,960,074 leke që rezultojnë në datën 08 Qershor 2023 të mbulohen nga kapitali i shoqërisë.
- (3) Të drejtat ndaj Ujësjetllës Kanalizime Pogradec Sha kalojnë në favor të aksionarit.
- (4) Pasqyrat financiare të datës 08 Qershor 2023 përbejnë bilancin përfundimtar të mbylljes së procedurave të likuidimit;
- (5) Miratimin e raportit të likuidatorit të datës 08 Qershor 2023;
- (6) Mbylljen e fazës së likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë.

Pasi u siguria se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

KRYETARI

Ilir Xhakolli

